



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Tiranë, më 21.07.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale kancelarie”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 44423000-1.

Vlera e Fondit Limit: 1,149,336 (një milion e njëqind e dyzet e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;
- b. Lista e çmimeve të artikujve shtojca 2;
- c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- ç. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 26, dhe të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP 1“. Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave,

autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare (2020,2021,2022) një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 40, neni 43 dhe neni 55 pika 4, të V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjisllacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, V.K.M Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. “ Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar ...”. Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara. AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë, rëndësisë së objektit të prokurimit, seriozitetit të marrëdhënieve kontraktuale me operatorë ekonomikë me aktivitet të vazhdueshëm në treg gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjisllacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik. Vendosja e ketij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe ligjin Nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë si dëshmi vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 4, neni 55, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi, çka rrit besueshmërinë te Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës. Për shkak të rëndësisë që ka vet Autoriteti Kontraktor, llojit të mallit objekt prokurimi, i rëndësishëm për ushtrimin e funksioneve të punonjesve të Autoritetit Kontraktor, me qëllim që të hyjmë në marrëdhënie kontraktuale me operatorë ekonomikë seriozë në treg, me performancë të mirë e të vazhdueshme, aplikojmë marzhin maksimal të vlerës së parashikuar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001-2015 (ose e përditësuar) mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë, e vlefshme dhe e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36, nenit 77, nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Nisur nga rëndësia e Autoritetit kontraktor të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht

produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të Autoritetit Kontraktor dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Autoritetit Kontraktor . Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

2.3.3 Deklaratë nga operatori ekonomik për cilësinë dhe origjinën e mallrave, objekt i këtij prokurimi.

Argumentim: Në bazë të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 8, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Autoriteti Kontraktor, për këtë procedurë prokurimi mjaftohet me një deklaratë nga operatori ekonomik për të provuar origjinën e mallrave dhe cilësinë e tyre, duke qenë se janë mallra të zakonshme konsumi në ambjentet e punës, për të cilat gjykojmë se nuk nevojiten dokumenta të tjera provues.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se merr përsipër me anë të mjeteve të tij të bëjë furnizimin e mallit objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor me shpenzimet e tij.

Argumentim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se merr përsipër me anë të mjeteve të tij të bëjë furnizimin e mallit objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor me shpenzimet e tij.

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

	Artikulli	Specifikimet teknike
1	Bllok shenimesh	Bllok shenimesh 76*76*450 flete *5 color
2	Leter A3 80gr/m2 e bardhe	Lloji: A3 Përdorimi: Për fotokopje e shtypshkrim. Lëmueshmëria 80-100 ml/min., të mos jetë e ricikluar, e paketuar me risma të qëndrojnë e rrafshët dhe të mos lëshojë pluhur në makinën e kopjimit/printimit.
3	Dosje arkivi me buton 10 cm	Dosje arkivi me buton 10 cm
4	Dosje kartoni me llastik te thjeshta	Dosje kartoni me llastik te thjeshta
5	Dosje kartoni me llastik te trashe 3cm, karton I trashe qe nuk perthyhet	Dosje kartoni me llastik të trashë 3 cm, karton i trashë që nuk përthyeret.
6	Dosje me mekanizem A4 kartoni 5cm me kuti 28.5*35*8.5cm	Dosje me mekanizem A4 kartoni 5cm me kuti 28.5*35*8.5cm

7	Dosje me mekanizem A4 kartoni 7cm me kuti 28.5*35*8.5cm	Dosje me mekanizem A4 kartoni 7cm me kuti 28.5*35*8.5cm
8	Evidenciator Highlighter	Evidenciator Highlighter me ngjyra
9	Gome e madhe	Gome e madhe cilesore
10	Korrektor stilo 8ml	Korrektor stilo 8ml
11	Letër A4 80gr/m2 e bardhë Rizma 500 fletë me 5 Rizma (pako)	<p>A4</p> <p>Pesha: 80 gr/m2</p> <p>Përmasa: 297 x 210 mm</p> <p>Ambalazhimi: Mbështjellëse kundër lagështirës</p> <p>Ambalazhimi: Kutu kartoni me kapacitet 5 risma. 1 (një)</p> <p>rismë duhet të përmbajë 500 fije A4</p> <p>Përdorimi: Për fotokopje & printer.</p> <p>Lagështia 3-4.5%</p> <p>Trashësia 100-110 µm</p> <p>Dukshmëria > 93 %</p> <p>Shkëlqimi 96-104 %</p> <p>CIE bardhësia 145-152 dhe pa llustër</p> <p>Letra të mos shkaktojë bllokimin e makinës fotokopjuese dhe as bllokimin e printerit.</p> <p>Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit ose fotokopjimit.</p> <p>Të mos lëshojë pluhur në makinën e kopjimit/printimit.</p> <p>E përshtatshme për printim nga të dyja anët.</p> <p>Nuk pranohet letër e ricikluar.</p>
12	Makine qepese dokumentash	Makinë qepëse dokumentash 24/6 26/6 metalike metalike e madhe ne formë gërshere, te jete cilesore.
13	Ndarese plastike 50x12mm, 6 ngjyra	Ndarëse plastike në formë shigjete me ngjyra te ndryshme
14	Stilolapsa one business 0.6	Stilolapsa one business 0.6, ngjyre blu
15	Stik I bardhe 40gr	Ky ngjites është i përshtatshëm, i pastër, me një kapak të veçantë për ta mbrojtur nga tharja. I shpejtë, i qëndrueshëm dhe ekonomik. Përhapet lehtë dhe ngjit menjëherë. Ngjit letër, letër termike, karton, etiketa e polisterol.
16	Stilolapsa te thjeshte k-15	Të jetë prej materiali plastik rezistent, i pajisur me kapak mbrojtës, me majë në formë sferike me përmasa 1 mm, në ngjyrë blu. Të jetë i lehtë dhe praktik në përdorim.
17	Tela makine 24/6	Tela makine 24/6
18	USB 16 Gb	USB 16 Gb
19	Zarfa plastik me vrima A4 micron te trasha te mbajne 50 flete A4	Zarfa plastic me vrima A4 100 micron të trashë të mbaje 50 fletë A4
20	Zarfa A4	Zarfa A4 230x324 mm, ngjyre te bardhe dhe e perbere me leter cilesore.

21	Zarfa 11x23	Zarfa 110x230mm ngjyre te bardhe dhe e perbere me leter cilesore.
22	Zarfa A5	Zarfa A5 190x260mm ngjyre te bardhe dhe e perbere me leter cilesore.
23	Tela aktesh 28mm 100 cope/pako	Tela aktesh 28mm 100 cope/pako
24	Tela aktesh 51mm 50 cope/pako	Tela aktesh 51mm 50 cope/pako
25	Liber protokolli I madh me 400 flete me kapak lekure formati A3	Liber protokolli I madh me 400 flete me kapak lekure formati A3
26	Blllok flete hyrje Magazina, A5 3 kopje *100 flete	Blllok flete hyrje Magazina, A5 3 kopje *100 flete
27	Blllok flete dalje Magazina, A5 3 kopje *100 flete	Blllok flete dalje Magazina, A5 3 kopje *100 flete
28	Lapsa me gome 2b	Lapsi grafit me formë hegzagonale është i përbërë nga dru shumë cilësor dhe është i ngjitur në gjithë gjatësinë e tij në mënyrë që të reduktohen rreziqet e thyerjes gjatë mprehjes ose në rastet kur ai bie në tokë.
29	Etiketa me adeziv me ndarje (A4)	Etiketa me adeziv me ndarje (A4)
30	Axhend A4 imitacion lekure 320 fq	Axhend A4 imitacion lekure 320 fq
31	Kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18)	Kuti arkive me permasa 40x28x18. Materiali që duhet të përdoret duhet të jetë karton 2500g/m2. Kutia përbëhet nga 2 kapakë , të gjitha këndet vijosen dhe janë 90 gradë, të gjitha brinjët lidhen me beze importi prapikot, për të realizuar një ngjiturje dhe një mbyllje sa më të mirë të kapakut që të bëjë të mundur sigurimin e fortësisë së nevojshme për tu mos u shkëputur gjatë përdorimit. Kutia vishet me syprinë njëngjyreshe 70-80 g/m2, kapaku në pjesën ballore duhet të ketë të vendosur një unazë që bën të mundur ajrosjen e dokumenteve Brenda në kuti, por edhe për lehtësi tërheqje gjatë përdorimit, kjo e dubluar dhe me vendodjen e një lidhëse në pjesën e poshtme të kutisë

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Për ushtrimin e detyrave funksionale stafi ka nevojë për furnizimin me materialet e domosdoshme të kancelarisë. Materialet e kancelarisë duhet të jenë sa më cilësore, ti përshtaten tërësisht specifikimeve teknike të kërkuara nga AK.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave datën 03.08.2023 ora 10:00. Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP, për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale kancelarie”.